



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1321/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Hasan Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Mitrovicë, për shkak se e njëjta çështje është gjykuar (res judicata).

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 24.12.2013, nga subjekti politik PDK dega në Mitrovicë, me të cilën pretendohet se në Qendrën e Votimit 1102X/11R pasi që është hapur kutia e votimit është gjetur një fletëvotim fals. Parashtruesi i ankesës thekson se për rastin në fjalë është njoftuar edhe Prokuroria e cila edhe ka dalë në vendin e ngjarjes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Mitrovicë gjeti se:

Për të njëjtën çështje PZAP-i ka vendosur me vendimin Anr.1012 /2013 të datës 04.12.2013.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e sipërshtënuar PZAP-i nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë sepse për këtë çështje PZAP-i ka vendosur me datë 04.12.2013 me vendimin Anr. 1012/2013, andaj është konstatuar si çështje e gjykuar (res judicata).

Duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 dhe neni 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 1321/2013 më datën 27.12.2013.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.